



VENDIM

Nr. 34 Date 13.10.2014

**PER SHPALLJEN E EKOSISTEMIT NATYROR TE LIQENIT TE FIERZES
"PARK NATYROR RAJONAL"**

Keshilli i Qarkut Kukes ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme, pas shqyrtimit te Relacionit dhe P/Vendimit te paraqitur nga AZHR-ja, bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/1/b,13, 54/1, ligjin Nr.8485 date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise", ligjin Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", (i ndryshuar) neni 11/1, VKM Nr.519, date 30.06.2010 "Për procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale", pika 4 si dhe vendimin e Kryesise se Keshillit te Qarkut Kukes, Nr.20, date 13.10.2014 "Per miratimin e P/Akteve per mbledhjen e Keshillit te Qarkut Kukes".

VENDOSI:

1. Shpalljen e ekosistemit natyror te Liqenit te Fierzes "Park Natyror Rajonal", sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Emertimi i ketij ekosistemi do te jete: "**Parku Natyror Rajonal - Liqeni i Fierzes**".
3. Kufijtë e zonws janë, si më poshtë:
 - a) **Kufiri verior:** Kufizohet me komunat Gjinaj, Golaj, Bashkine Krume ne rrethin e Hasit dhe komunat Fierze dhe Bytyç ne rrethin e Tropojes.
 - b) **Kufiri lindor:** Kufizohet me Komunat Terthore, Shtiçen, Bicaj ne rrethin e Kukesit dhe me komunen Fajza ne rrethin e Hasit.
 - c) **Kufiri jugor:** Kufizohet me Bashkine Kukes dhe me komunen Kolsh.
 - d) **Kufiri perëndimor:** Nis me kufizimin me komunat Surroj dhe Malzi ne rrethin e Kukesit.
4. Ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 8169 ha me nje gjatesi shtrirje 70 km. Ne kuoten maximale volumi i ujit eshte 3.2 miliard m³, ndersa thellesia max. eshte 167 m.

5. AZHR-ja ne bashkepunim me Drejtorine Rajonale te Sherbimit Pyjor, institucionet e tjera shtetore vendore, OJF-te mjedisore, komunitetin e biznesit te hartoje Planin e Menaxhimit te Parkut Natyror Rajonal "Liqeni i Fierzes" i cili do te miratohet nga Ministri i Miedisit




**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES**



6. Këshilli i Qarkut, miraton rregulloren e ruajtjes, administrimit dhe funksionimit të Parkut Natyror Rajonal “Liqeni i Fierzes”.
7. Kryetari i Këshillit të Qarkut Kukës, pas miratimit të vendimit për shpalljen e “Parkut Natyror Rajonal - Liqeni i Fierzes”:
- a) krijon administratën e parkut, duke përcaktuar strukturën dhe organiken e punonjësve, të cilët përgjigjen për ruajtjen dhe menaxhimin e tij, në bashkëpunim me organet e shërbimit pyjor dhe organet e tjera shtetërore e vendore;
 - b) ndan detyrat me strukturat ekzistuese shtetërore (pyjore, bujqësisë, projekte, etj) brenda zonës për ruajtjen e vlerave natyrore që janë identifikuar;
 - c) kërkon nga organet e specializuara dhe donatorët trajnimin e stafit për ngritjen e kapaciteteve njerëzore të administratës;
 - d) punon për zbatimin e planit të menaxhimit të parkut.
8. Drejtoria TIPS të bëjë publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit, si dhe në mjediset e njoftimeve publike të institucionit.
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Kryetari, Sekretari i Këshillit të Qarkut Kukës, Agjensia e Zhvillimit Rajonal, Drejtoria TIPS.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ibsen ELEZI



Konc: I.Shahu

Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B.Ngjeçi

U hartua në 4 (kater) kopje origjinale:

1. Zyres së Arkivit
2. Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës